

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË
NOTERE REZARTA B.KOÇI

Nr. 812 Rep.

Nr. 273 Kol.

KONTRATË SHITJE
“KUOTASH”



Në Tiranë, sot më 31.01.2019 (dymijë e nentembëdhjetë), para meje noteres publike Rezarta Koçi, anëtare e Dhomës së Noterisë Tiranë, me seli në rrugën Blv “Zogu i Pare”, Njesia Nr. 9, u paraqitën personalisht:

SHITESI:

Shoqëria “DAAM” shpk, e njohur si person juridik e pajisur me NIPT me nr **L72205042F**, me seli ne Paskuqan Tirane, e perfaqesuar nga administratori **Evis Berberi**, me datelindje 14.08.1989, shtetas shqiptar, madhor, me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, identifikuar nëpërmjet leternjoftimit dhe nr. Personal **H90814130W**.

BLERESI :

Brunilda Buli, me datëlindje 05.10.1985, lindur në Kavaje dhe banuese në Tiranë, shtetase shqiptare, madhore, me zotësi të plote juridike dhe për të vepruar identifikuar nëpërmjet leternjoftimit me nr personal **I56005089R**.

BAZA LIGJORE: Nenet 761 e vijues të Kodit Civil.

Palët me vullnetin e tyre të lirë, të plotë dhe në mirëkuptim të ndërsjelltë, më kërkuan redaktimin e kësaj kontrate, në kushtet dhe me të dhënat e mëposhtme:

TË DHËNA PARAPRAKE:

- I. **Evis Berberi** eshte ortak me 100% t të kuotave të kapitalit themeltar të Shoqërisë “DAAM” shpk. Në bazë të vendimit të Asamblesë së Ortakut te vetem të Shoqërisë “DAAM” shpk, ai ka vendosur të bëhet shitja e 100% te i kuotave qe **Evis Berberi** ka te Shoqërisë “DAAM” shpk te blereses **Brunilda Buli**.
- II. Bleresja behet ortak i shoqerise me nga 100 % te kuotave .
- III. Në bazë të udhëzimit nr. 2007/1, datë 2.3.2010, të Ministrit të Drejtësisë dhe Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës është kërkuar informacion nga noteri sipas njoftimit D pranë Regjistrisë të Barrëve Siguruese dhe nga përgjigjja e dhënë nga RBS, rezulton se mbi kuotat e kapitalit themeltar të Shoqërisë “AlbaScan” shpk nuk rezulton asnjë barrë siguruese.

NENI 1

Objekti

Objekti i kësaj kontrate është shitja e kuotave të individualizuara nga shitesi te bleresi kundrejt çmimit te percaktuar ne nenin 2 te kesaj kontrate.

NENI 2

Çmimi

- 2.1. Shitësi ia shet këto kuota blerësit kundrejt një çmimi 500000 (peseqind mije) Euro, të vlerës nominale. Palët deklarojnë se kesti i pare ne çmimin prej 8000 (tete mije) euro është paguar jashtë kësaj zyre noteriale nga blerësja në favor të shitësit, të cilët nuk kanë asnjë pretendim ndaj njeri tjetrit.

- 2.2. Ndërsa pjesa tjetër e cmimit total do paguhet në 5(pese) keste të për një periudhë kohore prej 5 vjetësh., konkretisht nga 100000 euro për çdo vit. Nëse pala blerese nuk paguan vlerën totale të cmimit të shitjes brenda 5 vjetësh, shoqëria do i kthehet palës shitesë dhe pagesat e bera gjatë kësaj kohe nuk do i kthehen mbrapsht palës blerese.

NENI 3

Kalimi i pronësisë

Me nënshkrimin e kontratës së shitjes dhe me regjistrimin e saj në zyrat e QKB-se, blerëses i kalon pronësia mbi kuotat e blera menjëherë, të lira dhe pa barre.

Me nënshkrimin e kësaj kontrate shitesë, Evis Berberi nuk ka me kuota dhe blerësja Brunilda Buli bëhet pronare me 100% të kuotave të Shoqërisë "DAAM" shpk.

NENI 4

Të ndryshme

- 5.1. Palët u porositën që të depozitojnë kontratën pranë Qendrës Kombëtare të Rregjistrimit për të bërë rregjistrimet përkatëse;
- 5.2. Kjo kontratë është hartuar në bazë të legjislacionit shqiptar dhe konkretisht të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë. Çështjet që kjo kontratë nuk i rregullon shprehimisht do të rregullohen nga dispozitat e Kodit Civil;
- 5.3. Çdo mosmarrëveshje që mund të lind nga interpretimi ose zbatimi i kushteve të kësaj kontrate do të zgjidhen me bisedime dhe mirëkuptim të ndërsjellë midis palëve në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi. Në rast se mosmarrëveshjet nuk zgjidhen me mirëkuptim kompetente për zgjidhjen e tyre është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Kontrata iu lexohet palëve të cilët e kuptojnë, e pranojnë përmbajtjen e aktit dhe e nënshkruajnë atë pa vërejtje, duke vënë emrin e mbiemrin, formë nënshkrimi kjo e përcaktuar në nenin 46 të Ligjit Nr. 7829, datë 01.06.1994 "Për Noterinë" (i ndryshuar).

Kontrata redaktohet në tre kopje origjinale, me përmbajtje dhe vlerë të njëjtë juridike, nga të cilat një kopje ruhet në arkivin e noterës.

Unë noterja, vërtetoj redaktimin korrekt të aktit dhe autenticitetin e nënshkrimeve, në bazë të ligjit Nr. 7829, datë 01.06.1994 "Për Noterinë" (i ndryshuar).

SHITESI

Shoqëria "DAAM" shpk
Prf/Evis Berberi

BLERES

Brunilda Buli

Brunilda Buli

NOTERE
REZARTA B. KOÇI



RBS
Regjistri i Barrëve Siguruese

Rr. e Dibrës, Qendra e Biznesit AK,
"Selvia", Kati V
TIRANË, SHQIPËRI
TEL/FAX.:355 4 2420005
TEL:355 4 2420006
Email: rbs@roen-al.com

REZULTATET E KËRKIMIT

| | |
|---------------------------------|---------------------|
| Numri i Rezultatit te Kerkimit: | D-20190129111817389 |
| Data e Rezultatit te Kerkimit: | 29.01.2019 |
| Ora e Rezultatit te Kerkimit: | 11:18:17AM |
| Lloji i Kerkimit: | |
| Numri i Dokumentit: | D-400-626-1461 |
| Referenca e Perdoruesit: | |

LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KERKIMI 0

DAAM SH.P.K.



Arniza Zekaj